Lavdije Tërfuri
për ndjekje

13.01.25

4. Tërfuri
117
13.01.2025

# REPUBLIKA E SHQIPËRISË
## KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
## KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Tiranë më 10/01/2025

Nr. 165

**Lënda:** Njoftim për vazhdimin e procedurave për dhënien e mandatit

**Drejtuar:** **Këshillit të Bashkisë Pukë**

Sheshi "Gjergj Kastrioti(Skënderbeu)", Pukë

**Partisë Socialdemokrate**

Rruga "Skënderbej", Blloku i Ambasadave, Tiranë

**Zj. Leze Ndrek Kolaj**

Pukë

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, në seancën publike të datës 08.01.2025, mori në shqyrtim projekt-vendimin "Për plotësimin e vakancës në këshillin e bashkisë Pukë, pas verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore të kandidatit, vendosi "Plotësimin e vakancës në këshillin e bashkisë Pukë, me kandidatin nga lista shumemërore e "Partisë Socialdemokrate" zj. Leze Ndrek Kolaj.

Bashkëlidhur do të gjeni vendimin nr. 8, datë 08.01.2025.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

**Sekretar i Përgjithshëm**

**(Në mungesë dhe me urdhër)**

**Majlinda ÇELMETA**

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**
**KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE**

Data: 8.1.2025 | Nr: 8 | Ora: 13:00

**VENDIM**

**PËR**

**PLOTËSIMIN E VAKANCËS NË KËSHILLIN E BASHKISË PUKË, ME KANDIDATIN NGA LISTA SHUMEMËRORE E "PARTISË SOCIALDEMOKRATE", ZJ. LEZE NDREK KOLAJ**

Në mbështetje të neneve 19, pikat 1, shkronja "n" e 2 dhe 164, pikat 2 dhe 4, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, nenit 11, të ligjit nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", Kreut V, të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit, "Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", pasi shqyrtova dokumentacionin përkatës,

**VËREJ:**

Me shkresën nr. 1966/2 prot., datë 28.10.2024, Këshilli i Bashkisë Pukë, ka njoftuar Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për krijimin e vakancës nga këshilltari, zj. Klodisa Ded Qeleshi, propozuar nga subjekti zgjedhor Partia Socialdemokrate.

Referuar nenit 164, pika 2 të ligjit nr.10019, and 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar, kandidati vijues nga lista shumemërore e Partisë Socialdemokrate, për Këshillin e Bashkisë Pukë, të cilit i kalon mandati i këshilltarit, është kandidati me numër rendor 08, zj. Leze Ndrek Kolaj.

Me shkresën nr. 3165, prot., datë 06.11.2024, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve i është drejtuar kandidatit për anëtar në Këshillin e Bashkisë Pukë, zj. Leze Ndrek Kolaj, me kërkesë për plotësim dokumentacioni.



NR 14P PROT

**V E N D O S:**

1. Plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Pukë, me kandidatin nga lista shumemërore e Partisë Socialdemokrate, zj. Leze Ndrek Kolaj.

2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

**Ilirjan CELIBASHI**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË – KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE



NR 14P PRÖI